

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "JAY GROUP" SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot me date 11.04.2023, bazuar ne legjislacionin shqiptar dhe kryesisht në ligjin nr. 7850 date 29. 7.1994 "Per Kodi Civil I Republikës se Shqipërisë" ndryshuar, ligjin nr. 9901 da të 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe në ligjin n r. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" ne , te nenshkruarit:

1. Fabio Campoli , shtetas italian, lindur ne Itali, i datëlindjes 19.01.1961, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane CA47757ML
2. Anna Chiara Maccione, shtetase italiane, lindur ne Itali, i datëlindjes 26.07.1971, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane CA72178CL.

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: "JAY Group" SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Lagjia 17,Rruga Rinia Durrsake, zona kadastrale 8517, nr pasurie 172/458, Durres, Shqiperi.Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrrojë veprimtarinë e saj si vijon:

1. Veprimtari artistike:
 - Shitje e veprave unike te artit në fushën e pikturës, skulpturës, objekteve artizanale, në çdo material (dru, terrakotë, gur, etj.)
 - Kurse arti dhe trajnimi, perfshire dhe online.
 - Botime dixhitale.
2. Natyra dhe Bujqësia.
 - Studime dhe projekte për mbrojtjen e faunës vendase, të te ardhurave dhe prodhimit bujqësor nepermjete instrumentave te kompanive siguruese.
 - Kurse trajnimi dhe rifreskimi, perfshire dhe online.

3. Shëndeti i mendjes dhe trupit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
- Kurse studimi dhe thellimi të disiplinave orientale, sportive dhe ushqimore, fizioterapisë, trajtimit oriental dhe osteopatisë;
 - Publikime edhe dixhitale
 - Mbledhja dhe ruajtja e frutave dhe bimëve spontane dhe të egra
 - Ngjarje sportive dhe kulturore
- Aktivitetet e përshkruara më sipër mund të realizohen në lokalitet ose në impiant publik dhe privat, në pronësi ose me qira.

Dhe çdo veprimati tjetër ekonomike që nuk bie ndesh me ligjet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.000.000 Leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Fabio Campoli: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 500.000 leke që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues Anna Chiara Maccione: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 500.000 leke që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i vendimarrjes.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë Fabio Campoli për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Firma e administratorit është si vijon _____

Neni 7: Viti ushtrimor


Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Në vitin e parë të krijimit të shoqërisë viti fillon nga data e regjistrimit deri me 31 dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

Fabio Campoli



Anna Chiara Maccione